



Kërkesa për Transparencë Gjyqësore

Përshkrim i shkurtër i politikave



28 Shkurt, 2017

Programi Kërko Drejtësi është i financuar nga Departamenti Amerikan i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL dhe e implementuar nga National Center for State Courts për të mbështetur një zhvillim të fuqishëm të kërkesës për drejtësi në Kosovë të bazuar në dëshmi. Nëpërmjet programit Kërko Drejtësi, NCSC është duke mobilizuar partnerët e Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të vepruar si agjentë të ndryshimit duke nxitur llogaridhënien, transparencën dhe integritetin në sektorin e drejtësisë.

Ky raport është bërë i mundur me mbështetje nga Departamenti Amerikan i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL përmes programit Kërko Drejtësi. Mendimet, të gjeturat, dhe konkludimet apo rekomandimet në këtë raport i përkasin autorit dhe nuk paraqesin mendimet e Departamenti Amerikan i Shtetit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës/INL ose të National Center for State Courts.

Kërkesa për Transparencë Gjyqësore

Përshkrim i shkurtër i politikave

Kërkesa për Transparencë Gjyqësore

Përshkrim i shkurtër i politikave

Përmbledhje ekzekutive

Procedurat gjyqësore transparente kultivojnë llogaridhënien e gjyqësorit. Qasja në seanca gjyqësore publike dhe publikimi i vendimeve gjyqësore promovojnë "sigurinë ligjore" për komunitetin ligjor dhe i mundësojnë shtypit të lirë dhe qytetarëve të kuptojnë më qartë punën që zhvillohet brenda sistemit gjyqësor pa e rrezikuar pavarësinë gjyqësore. Siç është thënë nga gjyqtari i Gjykatës Supreme të Shteteve të Bashkuara Louis D. Brandeis, "Drita e diellit thuhet të jetë dezinfektuesi më i mirë," dhe "qytetari individual duhet në njëfarë mënyre të mbledh dhe përhap informacione."

Obligimet sistemit të drejtësisë në Kosovë për transparencë (p.sh., seancat gjyqësore publike, qasja në vendimet e gjykatave, performanca e gjyqtarëve dhe prokurorëve, deklarimi financiar i gjyqtarëve dhe prokurorëve, etj.) janë të mishëruara në Kushtetutën e Kosovës dhe në disa ligje dhe rregullore. Megjithatë, dështimi i sektorit të drejtësisë në Kosovë të përmbush disa prej këtyre obligimeve për transparencë e mban publikun në errësirë, e pengon mundësinë e publikut që të mat efikasitetin dhe cilësinë e gjykatave, dhe natyrisht kontribuon në dyshimet e publikut se gjyqësori është i korruptuar.

E udhëhequr nga instrumentet përkatëse ndërkombëtare që zbatohen drejtpërdrejt në Kosovë,¹ ky përshkrim i politikave ofron një analizë ligjore dhe faktike mbi çështjet kyçe të transparencës gjyqësore, përfshirë publikimin e vendimeve gjyqësore, qasjen në seanca gjyqësore dhe në informacione të tjera të nevojshme për të rritur mbikëqyrjen dhe besimin e qytetarëve në gjyqësorin e Kosovës.

Konteksti dhe paraqitja e problemit

Koncepti i transparencës gjyqësore dhe publikimit të vendimeve të gjykatave është përmendur për dekada të tëra për shkak të presionit gjithnjë e më të madh nga financuesit dhe nga Komisioni Evropian². Megjithatë, shumë pak është bërë në këtë aspekt. Qytetarët e Kosovës vazhdojnë të përballen me vështirësi për qasje në seancat gjyqësore publike, në vendimet e gjykatave dhe në informacione të tjera të gjykatave. Si rezultat, kuptohet se publiku nuk ka besim në sistemin gjyqësor.

Gjatë marrjes së vendimit të saj në rastin *Pretto dhe të tjerët kundër Italisë*³, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) sqaroi se: "*Duke e bërë administrimin e drejtësisë të dukshme, publiciteti kontribuon në arritjen e qëllimit për gjykim të drejtë, garantimi i të cilit është një prej parimeve themelore të një shoqërie demokratike, sipas kuptimit të Konventës*⁴".

¹ Shih Nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mund të gjendet në:

<http://www.kushtetutakosoves.info/repository/docs/Constitution.of.the.Republic.of.Kosovo.pdf>.

² Raporti i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian, fq. 13 (tetor 2014). https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-kosovo-progress-report_en.pdf

³ Rasti *Pretto dhe të tjerët v. Italisë*, *Parashtrës nr. 7984/77*, 8 dhjetor 1983. Marrë nga: <https://cases.legal/en/act-echr1-57561.html>

⁴ *Ibid*, në fq.21.

E drejta në seancë gjyqësore publike

Duke qenë e respektuar nga demokracitë gjithandej botës, e drejta në shqyrtime gjyqësore publike daton shumë shekuj më përpara dhe tani është mishëruar në Kushtetutën e Kosovës dhe në sistemin ligjor si parim themelor kushtetues. E drejta në seanca publike – që rrjedh nga origjina e gjykimit të drejtë – shkon paralelisht me të drejtën e publikut për të qenë i pranishëm në procedurat gjyqësore – e drejta e publikut që të dijë⁵.

Në nenin 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) –traktat që është drejtpërdrejt i zbatueshëm në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës së Kosovës – e drejta në shqyrtim publik është pjesë e të drejtës më të përgjithshme për gjykim të drejtë. Ngjashëm, Pakti Ndërkombëtarë për të Drejtat Civile dhe Politike garanton se çdokush ka të drejtë në gjykim të drejtë dhe publik⁶. Kosova e ka përfshirë këtë të drejtë për shqyrtim publik në Kushtetutë për të theksuar karakterin e saj themelor "Gjykimi është publik, me përjashtim të rasteve kur gjykata, në rrethana të veçanta, konsideron se, në të mirë të drejtësisë, është i domosdoshëm përjashtimi i publikut, ose i përfaqësuesve të mediave, sepse prania e tyre do të përbënte rrezik për rendin publik ose sigurinë kombëtare, interesat e të miturve, ose për mbrojtjen e jetës private të palëve në proces, në mënyrën e përcaktuar me ligj"⁷. Qëllimi i një transparence të tillë ishte artikuluar mirë në *rastin Szucs* ku GJEDNJ ka sqaruar:

"Gjykata rithekson se mbajtja e seancave gjyqësore publike është parim themelor i mishëruar në

paragrafin 1 të nenit 6. Ky karakter publik i mbron palët në gjykatë nga administrimi i fshehtë i drejtësisë pa mbikëqyrje nga publiku; e po ashtu është edhe një prej mënyrave me të cilën mund të ruhet besimi në gjykata."⁸

Në të njëjtën frymë, Kosova më vonë ka miratuar legjislacionin kyç duke garantuar të drejtën kushtetuese për seanca gjyqësore publike:

- **Neni 7, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat:** "Të gjitha seancat gjyqësore do të jenë të hapura për publikun përpos nëse ligji e përcakton ndryshe"⁹.
- **Neni 294, paragrafi 1 Kodit të Procedurës Penale:** "Shqyrtimi kryesor është i hapur."¹⁰
- **Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore:** "Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike."¹¹
- **Neni 6 i Ligjit për Konfliktet Administrative:** "Në konfliktin administrativ, gjykata vendosë në bazë të shqyrtimit verbal, të drejtpërdrejt dhe publik."¹²

⁸ Rasti Szucs kundër Austrisë, 20602/92, Para. 42, 24.11.1997. Më tej në tekst Szucs. Marrë nga: <http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache%3AnWnEJ6Afy5cJ%3Ahudoc.echr.coe.int%2Fapp%2Fconversion%2Fpdf%2F%3Flibrary%3DECHR%26id%3D001-58113%26filename%3D001-58113.pdf%26TID%3Dthkbnlzk%20&cd=3&hl=en&ct=clnk>

⁹ Ligji Nr. 03/L-199 për Gjykatat, Gjendet në:

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2700>.

¹⁰ Kodi i Procedurës Penale Nr. 04/L-123, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2861>.

¹¹ Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2583>.

¹² Ligji Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2707>.

⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 31. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>.

⁶ Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Neni 14. Gjendet në: <https://treaties.un.org/doc/publication/unts/volume%20999/volume-999-i-14668-english.pdf>.

⁷ Kushtetuta e RKS, neni 31, para 3.

Megjithatë përkundër këtyre garancive ligjore, qytetarët, mediat dhe organizatat e shoqërisë civile po kanë vështirësi që të kenë qasje në seancat gjyqësore. Në praktikë, gjykatat jo vetëm që përjashtojnë publikun dhe mediat nga seancat gjyqësore, por edhe qytetarëve individual zakonisht u refuzohet qasja në objektet e gjykatave përveç nëse ai qytetar vjen ‘i armatosur’ me informacione për një seancë të caktuar gjyqësore, përfshirë informacionet për kohën kur mbahet seanca, numrin e gjykatores ku mbahet dhe emrin e kryetarit të trupit gjykues. Kërkesat për të ditur këto informacione për një rast janë të padrejta, jo vetëm pse ato nuk janë askund në ligj, por këto informacione shpesh nuk janë në dispozicion të publikut, e në disa raste as të vet palëve.

Rastet studimore për ilustrim:

- **E ashtuquajtura afera e “Stentave”** – Gjashtëdhjetë e katër persona, përfshirë 44 mjekë dhe infermiere që punojnë në institucionet shëndetësore publike ishin akuzuar për keqpërdorim të supozuar të pozitave të tyre duke drejtuar pacientët në spitale private në këmbim të pagesave të caktuara. Gjykata vendosi të **përjashtojë** krejtësisht publikun nga gjykimi sepse në gjykatore nuk kishte hapësirë të mjaftueshme për të gjithë qytetarët e interesuar. Përveç mungesës së bazës ligjore për mbyllje, gjykata po ashtu dështoi që të merrte iniciativën për të zgjidhur këtë çështje të hapësirës, për shembull, duke u mundësuar qytetarëve dhe mediave qasje të kufizuar përmes pajisjeve audio/vizuale për të siguruar transparencë.
- **Rasti i Gjyqtarit Salih Mekaj** – Në një rast të profilit jashtëzakonisht të lartë

që përfshinte akuzimin e një pjesëtari të gjyqësorit të Kosovës për “keqpërdorim të autoritetit ose pozitës zyrtare” dhe “ushtrim të ndikimit”, gjykata vendosi që ta zhvillojë tërë procedurën e kësaj lënde në seanca me dyer të mbyllura, duke **përjashtuar** publikun dhe mediat nga çdo dhe të gjitha seancat gjyqësore me arsyetimin se një shqyrtimi i hapur do të shkelte privatësinë dhe jetën familjare të të pandehurit, duke cituar nenet e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës¹³ që mundësojnë mbajtjen e seancave të mbyllura gjyqësore. Këtu gjykata pamundësoi qasjen në përfaqësisht 50 deri në 60 seanca gjyqësore me kërkesë të të pandehurit, me pëlqimin e prokurorisë, përkundër kundërshtimit të Mediave dhe OSHC-ve të bazuara në argumentin se vetëm një numër i vogël i këtyre seancave gjyqësore kishin të bënin me informacione të ndjeshme.¹⁴

- **Kërkesa për përvojë të studentëve në Klinikën e Drejtësisë** – si pjesë programit të klinikës D4J, studentët e klinikës të pajisur me kartela personale të identifikimit u caktuan të jenë të pranishëm në seancat gjyqësore. Megjithatë, studentëve ju pamundësua hyrja në gjykatat publike nga rojet e sigurimit në hyrje. Studentët u lejuan të hynin vetëm nëse kishin informacione për një gjykim të caktuar (orarin e seancës gjyqësore, numrin e gjykatores dhe gjyqtarin) – informacione që në fakt nuk janë në dispozicion të publikut. Përderisa gjykatat theksojnë se kjo bëhet në emër të sigurisë, ne mendojmë se këto masa të sigurisë nuk janë as të duhura e as

¹³ Gjykimi i Rastit *Mekaj* citoi Kodin e Procedurës Penale, Nenin 294.1 (mbyllja e një pjese apo të gjithë shqyrtimit)

¹⁴ Raporti i IKD-së (30 nëntor 2016)

proporcionale, dhe kështu krijojnë një pengesë arbitrare për qasje të publikut në seancat publike gjë që e ushqen frikën e publikut për gjykime jo të drejta dhe për gjykata të korruptuara.

Rëndësia e shqyrtimeve publike

Procedura transparente shërben për disa qëllime:

- Konfirmon dhe simbolizon obligimin e gjyqtarëve të marrin aktgjykimet dhe vendimet në emër të Popullit të Kosovës.
- Përforcon besimin e publikut në aktgjykimet e marra nga gjyqtarët.
- Mundëson të kuptuarit akademik në mesin e studiuesve profesionistë dhe studentëve lidhur me veprimet e sistemit gjyqësor.
- Rrit mundësinë e publikut që të kërkojë llogaridhënie.
- Siguron kontroll publik lidhur me mbrojtjen e të drejtës në gjykim të drejtë.
- Inkurajon ndryshimet e sjelljes së akterëve në sektorin e drejtësisë sa i përket profesionalizmit dhe drejtësisë.
- Zvogëlon mundësitë për korrupsion

Kufizimet e të drejtës për shqyrtime publike

E drejta në shqyrtim publik në Kosovë nuk është absolute dhe është subjekt i disa kufizimeve të caktuara. Kufizimet vijnë në pah kur janë në pyetje interesat morale, rendi publik ose siguria kombëtare në një shoqëri demokratike, ose kur kërkohen për të mbrojtur interesat e të miturve dhe jetën private të palëve ose kur është më se e domosdoshme sipas mendimit të gjykatës në rrethana të veçanta kur publiciteti do të dëmtonte interesat e

drejtësisë.¹⁵ Ekziston edhe një mbrojtje e mëtejshme ligjore e privatësisë që ofrohet për interesa të rëndësishme ekonomike dhe financiare të Republikës së Kosovës.¹⁶

Publikimi i vendimeve të gjykatës

Kushtetuta e Kosovës nuk e bën në mënyrë eksplicite dallimin ndërmjet “gjykimit” dhe “aktgjykimit”. Fjala gjykim siç përdoret në nenin 31 të Kushtetutës, duhet të interpretohet gjerësisht për të përfshirë seancat gjyqësore dhe aktgjykimet e vendimet që dalin nga këto seanca. Interpretimi i rreptë i fjalës “gjykim” në nenin 31 do të çonte në një rezultat absurd – që publiku ka të drejtë vetëm të jetë dëshmitar i paraqitjes së dëshmive në gjykim, por jo edhe të lexojë dhe të kuptojë përfundimet e gjykatës, ose çka është më e rëndësishme, bazën mbi të cilën ajo e mbështet vendimin e vet në një rast të caktuar. Prandaj, parimi i gjykimeve publike kërkon edhe publikimin e aktgjykimeve.

Për më tepër, sa i përket detyrës për të publikuar vendimet, neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ-së përcakton në mënyrë të qartë se në parim, aktgjykimet (vendimet, gjykimet etj.) duhet të shpallen publikisht. Fjalja e dytë e paragrafit të parë të nenit 6 thekson: ‘(...) Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t’i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.’¹⁷

¹⁵ Kushtetuta e RKS-së., Neni 31, para 3.

¹⁶ Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave, Neni 28.1.5.

¹⁷ KEDNJ, Neni 6.1.

Siç mund të vërehet, edhe nëse Kushtetuta e Kosovës nuk i përmend në mënyrë të qartë aktgjykimet ose vendimet, KEDNJ-së është e qartë në këtë pikë dhe ajo ka epërsi mbi ligjet e Republikës së Kosovës¹⁸.

Megjithatë, përkundër këtyre dispozitave themelore të mishëruara në Kushtetutën tonë dhe në instrumentet ndërkombëtare që janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë, çështja bërjes publike të vendimeve nuk është adresuar si duhet në ligjet kombëtare dhe në aktet e tjera nënligjore. Për shembull, **Neni 6 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Gjykatat (LGJ)** thekson se “Gjykatat publikojnë **aktgjykimet e plotfuqishme** në faqet e tyre zyrtare të internetit, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e arritjes së plotfuqishmërisë së aktgjykimit në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe rregullat e Këshillit Gjyqësor të Kosovës [...], duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale.

Ky përkufizim jashtëzakonisht kufizues “aktgjykime të plotfuqishme” i përcaktuar në nenin 6 të Ligjit për Gjykatat thjeshtë nuk është në përputhje me kërkesat e Kushtetutës së Kosovës, të cilat kërkojnë qartë që të publikohen të gjitha vendimet, duke lejuar mbajtjen e tyre të fshehtë vetëm kur gjykatat e konsiderojnë se është *më se e domosdoshme* ose kur e kërkojnë *rrethanat e veçanta* mbështetur në dy baza: a) mbrojtjen e interesave (d.m.th., *morali, rendi publik, siguria kombëtare, ose interesat e të miturve*) dhe b) mbrojtjen e privatësisë së palëve të përfshira. Prandaj, në Ligjin për Gjykatat formulimi “vendimet e plotfuqishme” paraqet shkelje të Kushtetutës së Kosovës, veçanërisht kur gjykatat e interpretojnë atë për tu liruar nga obligimi për tua dhënë të gjitha vendimet gjyqësore palëve të treta.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 19.

Edhe pse shteti mund të argumentojë se parimi “vetëm vendimi i plotfuqishëm” nevojitet për të mbrojtur supozimin e pafajësisë së palëve të përfshira në gjykim, rasti *Werner kundër Austrisë*¹⁹ e prek pikërisht këtë koncept. Në rastin *Werner*, GJEDNJ hodhi poshtë argumentin e shtetit austriak se publikimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë do të shkelte parimin e supozimit të pafajësisë mbi bazën se: “mund të jetë me rëndësi për personin përkatës që publiku të njoftohet për faktin se është hequr dyshimi lidhur me të”²⁰.

Për më tepër, në rastin *Szücs kundër Austrisë*²¹, GJEDNJ konstatoi se ka shkelje të së drejtës në gjykim publik kur vendimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit nuk vihen në dispozicion të palëve të treta por vetëm të një kategorie të kufizuar të njerëzve.

Ngjashëm, **Udhëzimi administrativ për anonimizimin dhe publikimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore** është po ashtu jo kushtetues pasi që përmban gjuhë identike që e kufizon publikimin.²²

Pavarësisht natyrës jo-kushtetuese të nenit 6 të Ligjit për Gjykatat, në shumicën e rasteve gjykatat aktualisht nuk janë duke i publikuar madje as vendimet e plotfuqishme dhe të ekzekutueshme. Aktualisht, vetëm një pjesë e vogël e vendimeve të tilla mund të gjenden

¹⁹ Rasti *Werner kundër Austrisë* (138/1996/757/956), 24 nëntor 1997. Marrë nga:

<http://www.bailii.org/eu/cases/ECHR/1997/92.html>.

²⁰ *Ibid*, faqe 59.

²¹ Rasti *Szücs kundër Austrisë*, 20602/92, 24.11.1997.

Marrë nga:

<http://webcache.googleusercontent.com/search?q=cache%3AnWnEJ6Afy5cJ%3Ahudoc.echr.coe.int%2Fapp%2Fconversion%2Fpdf%2F%3Flibrary%3DECHR%26id%3D001-58113%26filename%3D001-58113.pdf%26TID%3Dthkbhnlzk%20&cd=3&hl=en&ct=clnk>

²² Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Udhëzimi Administrativ për Anonimizimin dhe Publikimin e Vendimeve të Plotfuqishme të Gjykatave. 02.02.2016. Marrë nga:

<http://www.gjyqesori-rks.org/en/legislation/list?id=0&type=3>

online, përkundër investimit të KGJK-së në krijimin e një platforme online me qëllim të publikimit të informacioneve për gjyqësorin.

Ndonëse neni 6 i KEDNJ-së dhe neni 31 i Kushtetutës së Kosovës nuk e përcakton si obligim absolut për shtetin që të publikojë të gjitha vendimet e gjykatës, jurisprudenca e KEDNJ-së qartazi e mbështet publikimin e vendimeve të gjykatës "si mënyrë për të siguruar transparencën dhe për të mundësuar mbikëqyrjen nga publiku; ajo është edhe një prej mënyrave me të cilat mund të ruhet besimi në gjykata, si të larta ashtu edhe të ulëta²³." Si shembuj lokalë të kësaj transparence, është me rëndësi të theksohet se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës i publikon vendimet e saj, përderisa Ministria e Drejtësisë po ashtu i publikon online të gjitha vendimet civile dhe administrative në të cilat qeveria është palë.

Rëndësia e publikimit të vendimeve

Publikimi i vendimeve shërben për disa qëllime:

- Krijon **siguri ligjore** për qytetarët dhe bizneset duke u dhënë gjykatave dhe avokatëve qasje në praktikën gjyqësore përkatëse dhe bindëse.
- Krijon një procedurë transparente publike e cila i detyron institucionet mbikëqyrëse të drejtësisë²⁴ që të arsyetojnë në mënyrë publike vlerësimet ose ngritjen në detyrë të akterëve gjyqësorë.
- Mundëson të kuptuarit akademik në mesin e studuesve profesionistë dhe studentëve lidhur me jurisprudencën.

- Ofron informacione relevante për stimulimin e reformave institucionale.

Rekomandimet

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale të paraqitur në këtë njoftim të shkurtër, janë dhënë këto rekomandime.

- Të harmonizohet legjislacioni vendor lidhur me publikimin e vendimeve të gjykatave dhe transparencën gjyqësore me Kushtetutën e Kosovës dhe me instrumentet drejtpërdrejtë të zbatueshme në Kosovë.
- Të hartohet një protokoll racional për seanca gjyqësore publike për të siguruar qasje me kohë të publikut në oraret e seancave gjyqësore dhe lokacionet.
- Të trajnohet stafi administrativ dhe i sigurimit i gjykatave për obligimin e tyre që t'i mundësojnë publikut qasjen në seancat gjyqësore.
- KGJK duhet zyrtarisht të konsultohet me Drejtorin e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave për të siguruar që Udhëzimi Administrativ lidhur me anonimizimin të mos kërkojë më tepër redaktim se sa që kërkohet me ligj.
- Të trajnohet dhe mobilizohet stafi i gjykatave për anonimizimin dhe publikimin e vendimeve të gjykatave me kohë.
- Të shqyrtohen mundësitë për anonimizim të automatizuar ose me ndihmë të kompjuterit të vendimeve të gjykatave.
- Të adresohen kufizimet buxhetore dhe në burime njerëzore në ofrimin e qasjes publike në informacione të gjykatave.

²³ Rasti *Sutter kundër Zvicrës* (20602/92), 22 shkurt 1984. Marrë nga: [http://hudoc.echr.coe.int/eng#{"itemid":\["001-57585"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng#{)

²⁴ Këto institucione përfshijnë Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës.



www.levizjafol.org | info@levizjafol.org
Rr. Andrea Gropa No. 35 10000 Prishtinë - Kosovë